

Basri (Hajzer) Beqiri

(25.06.1976, shqiptar nga Akraštica/Okraštica, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, pjesëtar i UÇK-së)

Basriu e ka mbaruar shkollën e mesme në Vushtrri/Vučitrn. Në UÇK ka aderuar më 26.06.1998. Vepronte pranë shtabit të UÇK-së në Akrašticë/Okraštica. Nga mesi i muajit korrik të vitit 1998, u nis për një transport të ri armatimesh nga Shqipëria. Pas kthimit, ka marr pjesë në luftimet në Junik dhe rrethinë. Gjatë betejës që me forcat serbe u zhvillua më **12.08.1998** në **Junik**, një predhë ka rënë afër Basriut dhe e ka plagosur rëndë. Bashkëluftëtaret e kanë çuar në spital në *Mëhallën Gacafferri*. Më pas, u transferua në Tiranë më 14.08.1998, ku nga plagët e rënda ndërroi jetë më 18.08.1998. U varros në varrezat e Tiranës.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Athem (Lush) Selmonaj

(1921, shqiptar nga Rastavica, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, gjashtë fëmijë)

Forcat serbe e kishin nisur granatimin e fshatit Rastavicë/Rastavica më 25.05.1998. Bashkëshortja e Athemit, Zoja, ka pësuar nga një granatë që ka rënë në oborrin e familjes Selmonaj [të shikohet regjistrimi në faqen 21]. Një ditë më vonë, më 26.05.1998, Athemi u arratis me të rejat dhe nipërit në fshatin fqinj të **Prekollukës/Prekoluka** dhe u vendos te e bija Time. Kur forcat serbe filluan të gjuanin me minahedhëse edhe Prekollukën/Prekoluka më **12.08.1998**, të gjithë anëtarët e familjes së Athemit u zhvendosën në Rashiq/Rašić, ndërkaq ai ka mbetur në shtëpinë e vajzës. Dy ditë më vonë, djali i Athemit, Avniu, ka shkuar me disa të afërmit e tij në Prekollukë/Prekoluka, ku e kanë gjetur shtëpinë e Times të djegur. Por, nuk kishte kurrfarë gjurmësh të Athemit. Ai edhe sot konsiderohet i zhdukur dhe si i tillë është regjistruar në evidencën e KNKK-së, me numrin rendor BLG-803266-01.

Burimet: deklarata A.S, FDH-19240; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Sylë (Pajazit) Qufaj

(1.05.1918, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, tre fëmijë)

Syla me bashkëshorten Fazen kanë mbetur në shtëpi më **12.08.1998**, kur forcat serbe e sulmuan fshatin e tyre. Djali i tyre, Ademi, u largua me familjen e tij nga fshati. Ademi bëri përpjekje që të kthehej në shtëpi në mbrëmje të së njëjtës ditë, por pa sukses, sepse forcat serbe kishin depërtuar në fshat **[Prilep]**. Disa ditë më vonë, dikush i kishte lajmëruar familjarët me telefon se policia e kishte qar Fazen në Deçan/Deçane dhe se ajo gjendet në shtëpinë e Sylë Cacajt. Po ashtu, familjarët mësuan se forcat serbe e kishin vrarë Sylën më 12.08.1998. Pas tri javësh, kur luftimet përreth fshatit pushuan, Ademi u kthe në fshat dhe prapa shtëpisë familjare e zbuloi trupin e të atit. Po atë ditë, ai shkoi te një postbllok policor dhe e paraqiti rastin. Policia shkoi në vendin e ngjarjes dhe e barti trupin e Sylës në Gjakovë/Đakovica për obduksion. Të nesërmen, pas obduksionit, një djalë tjetër i Sylës e ka marr trupin e të atit dhe varrimi i viktimit u bë në varrezat e Prilepit/Prilep po atë ditë. Në muajin korrik të vitit 1999, mbetjet mortore të Sylës janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Prilep.

Burimet: deklarata A.Ç, FDH-19241; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 121, FDH-23857; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

Arben (Bajram) Ahmetaj

(18.01.1970, shqiptar nga Gllgjani/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Arbeni u bë pjesëtar i UÇK-së më 28.03.1998. Ishte komandant i mbrojtjes kundërajrore në zonën operative të *Dukagjinit/Dukađini*. Ka rënë në betejë me forcat serbe që u zhvillua më **13.08.1998** në fshatin **Irzniq/Rznić**. Arbeni prehet sot në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gllgjani/Glodane.

Burimet: deklarata Z.S, FDH-12766; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.